



Prafuar me: Prilijeno: 23.09 2021		
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-400-	58553	

**MARRËVESHJE E PARTNERITETIT**

**NDËRMJET**

**PROJEKTIT PËR KOMUNA TRANSPARENTE, EFEKTIVE DHE LLOGARIDHËNËSE- DAI GLOBAL LLC**

**DHE**

**KOMUNËS SË LIPJANIT**

**DHE**

**INTERADRIA L.L.C.**

- I. Përderisa, DAI Global LLC, që operon përmes entitetit të vet lokal, Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse - DAI GLOBAL LLC, duke zbatuar Projektin Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM), mbështet komunën e LIPJANIT ("Komuna"), duke blerë bashkërisht mallra dhe shërbime nga INTERADRIA L.L.C. ("Shitësi"), që gjendet në Prishtinë, Kosovë; së bashku të identifikuar më tutje si "Palët";
- II. Informata të përgjithshme dhe kontributet në prokurim

Aktiviteti i USAID-it Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse është projekt pesëvjeçar i financuar nga Agjencia e SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar, i cili filloi më 11 Janar 2017 dhe është planifikuar të përfundojë në Janar 2022. Projekti është dizajnuar për të promovuar barazinë, transparencën dhe mbikëqyrjen në prokurim, duke ofruar ndihmë të gjithanshme në 38 komunat e Kosovës, me theks të posaçëm tek pesë komuna të fokusimit, me anë të mentorimit, trajnimit dhe udhëzimit për të përmirësuar llogaridhënien për fonde e shpenzime publike.

Komuna nuk do të pranoj asnjë kontribut monetar të ndërlidhur me këtë Grant. Në bazë të këtij asistence të administruar nga Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse-DAI Global LLC, Agjencia e SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar do të sigurojë bashkërisht mallra dhe shërbime komunës së Lipjanit, mbështetje në "Blerja e Pajisjeve dhe Instrumenteve për menaxhim të kontratave, dhe Pajisjeve të TI -së dhe Sigurisë për komunën e Lipjanit" ("Projekti") duke blerë bashkërisht mallra dhe shërbime nga InterAdria L.L.C. përmes një Nënkontrate. Kostoja totale e projektit është **14,168.99 EUR**. Kontributi i projektit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse i USAID-it për projektin, në shumë prej **6,535.99 EUR** nuk i nënshtrohet Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe është për prokurimin e mallrave ose shërbimeve të specifikuara në Shtojcën A-Seksioni I. Kontributi i komunës, në shumë prej **7,006.82 EUR**, është për prokurimin e mallrave dhe/ose shërbimeve të specifikuara në Shtojcën A-Seksioni II, dhe i nënshtrohen TVSH-së në shumë prej **626.18 EUR**, që e ngre totalin e kontributit të komunës në **7,633.00 EUR**. Komuna do t'ia paguaj kontributin e vet dhe TVSH-në e ndërlidhur drejtpërsëdrejti Shitësi.

Ky grant për Komunën e Lipjanit i nënshtrohet terneve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje të partneritetit dhe është në fuqi nga data e nënshkrimit nga zyrtarët e autorizuar të Palëve. Blerja e mallrave dhe/ose shërbimeve nga Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse-DAI Global LLC do të menaxhohet nga Nënkontrata ose Urdhër-blerja që do të miratohet ndërmjet Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse-DAI Global LLC dhe Shitësi.



2. Palët e kësaj Marrëveshjeje të partneritetit zotohen që të punojnë së bashku që të arrijnë një shkallë të lartë të bashkëpunimit dhe të suksesit gjatë zbatimit të projektit. Palët zotohen që të zgjidhin përmes marrëveshjeve të ndërsjella, nëse ndonjë çështje nuk zgjidhet me marrëveshje të përbashkët, palët bien dakord për ndërmjetësim në pajtim me Rregullat e Qendrës Alternative për Zgjidhjen e Kontesteve në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë.
3. Kjo Marrëveshje e partneritetit ekzekutohet në tri (3) kopje origjinale; një (3) në gjuhën angleze dhe një (3) në gjuhën shqipe. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.
4. Kjo Marrëveshje e partneritetit do të jetë në fuqi deri në përfundimin e Certifikatës/Aktit të pranimit ose marrëveshjes së ndërsjellë me shkrim të Palëve.

Dakorduar nga palët më 21.Shtator 2021.

  
Imri Ahmeti  
Kryetari i komunës  
Komuna Lipjan



  
Aferdita Mekuli  
Drejtori i projektit  
TEAM-DAI Global LLC

  
For: Shkumbin Kajtazi  
Drejtori  
INTERADRIA L.L.C.





10.	Supply, usage training and transport to the set destination of: <b>Digital Caliper LCD Display Professional Digital Caliper</b> LCD Display mm/inch Digital 0-300mm; Accuracy 0.02mm Vernier Caliper Gauge Micrometer Measuring Tool. Warranty: 24 months	7	47.46 €	332.22 €
11.	Supply and transport to the set destination of Security Camera set system with DVR and 5 cameras: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Defender Security DFR40/41 5MP HD cameras</li> <li>• Blupont Professional-Grade DVR Storage &amp; Playback Systems</li> </ul> Advanced H.265 Multi-Channel DVR System With 4K Video Output 8-Channel RCA BNC Analog CCTV Input <ul style="list-style-type: none"> <li>• HDD Western Digital Purple 4TB - WD40PURZ</li> <li>• Monitor FUEGO 40EL610ANDT</li> <li>• 40" Full HD</li> <li>• Triplite 1250W APS X Series 12VDC 230V</li> <li>• Inverter/Charger with Auto Transfer Switching, 2 C13 Outlets</li> <li>• 1-piece battery 200Ah Invertor, 1250W with battery industrial hermetically with Gel or Acid Liquid, 12VDC/200Ah – Life Cycle up to 5 Year.</li> <li>• 1-piece Power supply minimum 10A for power supply to cameras.</li> <li>• Installation with cables</li> <li>• Training for staff</li> </ul> Warranty: 24 months	1	1,666.95 €	1,666.95 €
12.	Supply, mounting and transport to the set destination of LED TV 60", HDMI 4K UHD, black Technical Specifications: <b>TV LED LG 60UP80003LR</b> ; Dimensions: 60"; Resolution: 4K Ultra HD (3840 x 2160); Smart TV: Yes; Processor: A5 4K processor; 3x HDMI 2.0; 2x USB; 1x Lan connector; Wifi-Yes; TV wall-mount holders. Warranty: 24 months	1	594.92 €	594.92 €
<b>Total Kontribusi USAID TEAM</b>				<b>6,535.99 €</b>